



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLORE  
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS  
NR. 1050 PROT.  
DATA 30.04.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
FAKULTETI I SHËNDETIT

Nr. 5/1 prot.

Vlorë, më 29.04.2024

**VENDIM**

Nr. 2, datë 29.04.2024

**PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES  
TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË DHE ANËTARËT E  
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË FAKULTETIN E SHËNDETIT**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të "Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin 'Ismael Qemali' Vlorë", Neni 18 pika 3, Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Shëndetit, pas mbledhjes së kryer;

**VENDOSI**

1. Data 07.05.2024 shënon ditën e fillimit të procedurës për regjistrimin e kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë dhe Anëtarë të Komisioneve të Përhershme në Fakultetin e Shëndetit, Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë.
2. Procedura e regjistrimit do të përfundojë në datën 13.05.2024.
3. Orari i regjistrimit të kandidatëve do të jetë orari zyrtar 08:00- 16:00.
4. Kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë zyrës së Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Shëndetit.
5. Regjistrimi i kandidatëve do të bëhet vetëm nëse dokumentacioni është i plotë dhe do të shoqërohet me vërtetimin përkatës për secilin kandidat.
6. Vendimi do të publikohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Shëndetit dhe në site-in zyrtar të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al).
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Shëndetit**

Vasilika Prifti (Kryetare)

Stiliana Brokaj (Anëtare)

Ela Kamberaj (Anëtare)

Sekretare e KZF

Erlini Kokalla



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLORË  
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS  
NR. 1050/11 PROT.  
DATA 30.04.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT

Nr. 5/2 prot.

Vlorë, më 29.04.2024

**NJOFTIM**

**PËR DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE  
PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË DHE  
ANËTARËT E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË FAKULTETIN E SHËNDETIN,  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të "Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin 'Ismail Qemali' Vlorë", Neni 25, si dhe Vendimit Nr.2 të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Shëndetit, datë 29.04.2024 "Për hapjen e procesit së regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë dhe Anëtarë të Komisioneve të Përhershme në Fakultetin e Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali".

Kërkesa për kandidim nga personat e interesuar depozitohet nga kandidati në Fakultetin e Shëndetit, kati 3-të godina D, nga data 07.05.2024 deri në datën 13.05.2024, brenda orarit zyrtar 08:00-16:00.

**1. Kandidatët për Drejtues të Njesisë Kryesore dhe Drejtues të Njesisë Bazë duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë vijon;**

a) Kërkesa për kandidim, e cila përmban;

- Emër,
- Atësi,
- Mbiemër,
- Datëlindje,
- Gjini,
- Shprehjen e vullnetit për kandidim

b) Kopje të dokumentit të identifikimit,

c) Formularët e vetëdeklarimit (tërhiqen pranë KIZ), të cilat përfshijnë;

- Deklarimi se kandidati nuk ka fituar 2 mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion,
- Mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik
- Deklarimi se nuk ka shkak për të qënë objekt i ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE  
FAKULTETI I SHËNDETIT

nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”,

- Deklarimi që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale,
- Deklarimi për neutralitetin politik, për mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.

**2. Kandidatët për Anëtarë të Komisioneve të Përhershme të Njesisë Bazë duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë vijon;**

a) Kërkesa për kandidim, e cila përmban;

- Emër,
- Atësi,
- Mbiemër,
- Datëlindje,
- Gjini,
- Shprehjen e vullnetit për kandidim

b) Kopje të dokumentit të identifikimit

c) Formularët e vetëdeklarimit (tërhiqen pranë KIZ), të cilat përfshijnë;

- Deklarimi se kandidati nuk ka fituar 2 mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si autoritet drejtues në postin, në të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion,
- Mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik
- Deklarimi se nuk ka shkak për të qënë objekt i ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”,
- Deklarimi që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penal,
- Deklarimi për neutralitetin politik, për mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.

**3. Kandidatët për Anëtarë të Komisioneve të Përhershme të Njesisë Bazë nga radhët e studentëve duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë vijon;**

d) Kërkesa për kandidim, e cila përmban;

- Emër,
- Atësi,
- Mbiemër,
- Datëlindje,
- Gjini,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
FAKULTETI I SHËNDETIT

- Shprehjen e vullnetit për kandidim
- e) Kopje të dokumentit të identifikimit,
  - f) Vërtetim që provon se është student me kohë të plotë në Fakultetin e Shëndetit,
  - g) Propozim nga jo më pak se 30 studentë, pjesë e trupës zgjedhore, sipas standardeve të parashikuara në rregullore, të cilët krahas emrit, mbiemrit dhe nënshkrimit, vendosin në shkresën e propozimit edhe ID përkatëse.
  - h) Dokumentin që vërteton mesataren e notës mbi bazën e provimeve të dhëna deri në momentin e kandidimit.

**Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Shëndetit**

Vasilika Prifti (Kryetare)

Stiliana Brokaj (Anëtare)

Ela Kamberaj (Anëtare)

Sekretare e KZF

Erlini Kokalla